

Ankesat e trajtuara nga Klinika e Ligjit

te Komitetit Shqiptar te Helsinkit

Përgjatë këtij harku kohor në Klinikën e Ligjit janë përcjellë dhe janë trajtuar 132 ankesa në total. Ndaj tyre, KShH ka realizuar një sërë shërbimesh, si këshillim ligjor falas, ndërhyrje në institucionë shtetërore, verifikim në vend, përfaqësim gjyqësor, etj., gjithnjë pa veçuar reagimin publik.



Dominojnë ankuesit e rritur meshkuj me 86% të totalit, ndërsa përsa i përket kombësisë së ankuesve vetëm 6% e ankesave janë drejtuar nga persona të pakicave kombëtare.

Më së shumti ankesat lidhen me shkeljen e të drejtave në sistemin penicitar me 51% të totalit. Pranë Klinikës janë adresuar dhe ankesa të natyrës civile, të cilat përfaqësojnë 22% të totalit.

Në pjesën më të madhe të shqetësimeve të adresuara nga qytetarët është trajtuar ankesa e përcjellë prej tyre (e 26% të rasteve në total si dhe është ofruar këshillim ligjor në 61% të rasteve).

në harkun kohor Janar-Qershori 2023

Përsa i përket shtrirjes gjeografike rreth 21% e ankesave janë përcjellë nga Shkodra, i cili rezulton qyteti me më shumë ankues, ndjekur nga Tirana me 15% dhe Lezha me 14% të totalit të rasteve.

75% e ankesave janë drejtuar nga shtetas të cilët ndodhen në institucionet penicitare dhe 25% nga shtetas në gjendje të lirë.



Dominojnë ankesat me objekt cënimin e nenit 6 të KEDNJ-së (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 3 të KEDNJ-së (Ndalimi i torturës), me 18% dhe 14% të totalit.

Vijon të jetë problematike situata përsa i përket respektimit të së drejtës së informimit ku rreth 18% e ankesave të administruara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit kanë pasur si objekt mosrespektimin e saj.